

*Ajetet*  
**MEKKASE**  
**DHE**  
**MEDINASE**  
(NJOHURI TË DOBISHME)



**THIRRIASLAME** 

PËRKTHEU DHE PËRSHTATI:  
**FAIK ASANI**

# Ajetet

## Mekkase dhe Medinase

(Njohuri të dobishme)

Përktheu dhe përshtati:

**Faik Asani**

Me date: 05/09/2012



Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit

Falenderimi i takon vetëm Allahut, vetëm Atë falenderojmë! I kërkojmë ndihmë, falje dhe mbrojtje nga të këqijat e veteve tona e nga të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush që e humb dhe atë që Ai e humb nuk ka kush e udhëzon! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun ashtu siç duhet pasur frikë Ai dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë".

"O njerëz! Jini të bindur (dhe përmbushni detyrimet) ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një vetje (Ademit) dhe nga ajo, krijoi palën (bashkëshorten) e saj. Nga ata të dy, Ai krijoi burra dhe gra të shumtë. Kijeni frikë Allahun, nëpërmjet të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella, dhe mos i ndërprisni marrëdhëniet me të afërmit. Allahu është Vëzhgues mbi ju".

"O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun dhe flisni fjalë të drejta. Ai do t'ju drejtojë ju tek veprat e mira dhe do t'ju falë juve gjynahet tuaja. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij , me të vërtetë që ka arritur fitore të madhe".

Fjalët më të vërteta janë fjalët e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-Allahuejhi ue selem. Gjërat më të këqia janë gjërat e shpikura! Çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje të çon në zjarr!

Ky libërth që gjendet në duart e juaja është një pikënisje dhe një lehtësim për njohjen e disa çështjeve të Kur'anit apo ndryshe thënë për njohjen e ajeteve Mekkase dhe ato Medinase, normalisht në këtë libërth do të përmendim se si e

kanë ruajtur sahabët, tabiinët dhe dijetarët Kur'anin dhe renditjen, do të përmendim edhe si ndahen suret mekkase prej atyre medinase, gjashtu do të përmendim se çfarë rëndësia kanë, si i kanë radhitur, sa sure ka Kur'ani dhe si e kanë ruajtur etj...

E këtë libërth jam munduar që ta bëj në mënyrën më të shkurt dhe më të thjeshtë, për ta kuptuar më lehtë lexuesit.

**Do fillojmë prej të sahabët dhe tabiinët gjithashtu edhe dijetarët duke treguar se si e kanë ruajtur Kur'anin.**

**1-Ruajtja e fesë nga ana e sahabëve:** Sahabet kanë një specifik nga të gjithë gjeneratat tjera, përshkak të udhëzimit të tyre, duke e ditur shumë mirë edhe gradën, vlerën dhe shkakun se përçfarë ka zbritur Kur'ani ajet për ajet, duke e ditur me saktësi dhe për çfarë kohe ka zbritur dhe çfarë vendi, për këtë që thamë deri tash do cekim fjalën e Ibn Mes'udit r.a ku ka thënë: "Vallahi nuk ka zbritur ajet prej Kur'anit apo sure vetëm se e kamë ditur shkakun se pse ka zbritur, dhe nëse di dikë që di më shumë se une, do të kisha udhtuar për te ai".

**2-Ruajtja e fesë nga ana e tabiinëve:** Janë mu ata të cilët e ruajtën këtë fe dhe ishin më të diturit rreth Kur'anit, pse jo, duke e ditur se ato ishin nxënësit e sahabëve, u angazhoheshin me këtë dituri dhe e ruajtshin dhe e përcjellshin në gjitha anët e botës, për një thënie apo hadith të Pejgamberit alejhi selam ato pyetshin siç ishte Ikrime rreth ajetit të Kur'anit, dhe u përgjigjke duke aluduar dhe treguar se ku ka zbritur dhe se në cilën kodër duke bërë isharet kah Sel-lea'.

**3–Ruajtja e fesë nga ana e Dijetarëve:** Janë ata që ruajtën këtë fe dhe që ishin prej atyre që dinë dhe dallojnë ajetet mekkase dhe medinase, edhe atë duke ditur dhe përmendur në librat e tyre ajet për ajet, sure për sure me renditje me një precizitet të jashtëzakonshëm. Dhe kanë ditur kohën kur ka zbritur dhe vendin ku është zbritur, dhe normalisht kjo është një shkencë në vete.

**4–Rëndësia e ajeteve Mekkase dhe Medinase:** Prej çështjeve të çmuara në lëmin e Kuranit dhe prej asaj çfarë ka zbritur, renditja prej asaj çka ka zbritur në mekke dhe medine, dhe çfarë do ajeti që ka zbritur ne mekke quhet mekkij, dhe çfarë do ajeti që ka zbritur ne medine quhet medenij, dhe ka prej ajeteve që kanë zbritur ajete në mekke, ndërsa ato ajete janë medinase, po edhe anasjelltas dhe ka prej ajeteve që kanë zbritur ajete në medine e që janë mekkase, dhe ka prej sureve që kanë zbritur në mekke e që janë sure medinase, po edhe anasjelltas dhe ka prej sureve që kanë zbritur në medine e që janë mekkase.

### **5–Renditja e sureve Mekkase dhe Medinase:**

- **Sure Mekkase: Janë 82 Sure.**

**Dhe ato janë siç vijojnë:** El-Enam, Junus, Hud, Jusuf, Ibrahim, El-Hixhr, Nahl, El-Isra', Kehf, Merjem, Taha, El-Enbija, El-Haxh, Mu'minun, Furkan, Es-Shuara', En-Neml, Kasas, Ankebut, Er-Ruum, Lukman, Sexhdeh, Sebe', Fatir, Jasin, Sad, Zumer, Gafir, Fussilet, Shura, Zuhruf, Duhan, Es-Safat, Edh-Dharijjat, Et-Tur, Nexhm, Kamer, Vakiah, Mulk, El-Xhathijeh, El-Ahkaf, Kaf, Nuh, Xhin, Muzzemil, Mudethir, Kijameh, El-Insan, Kalem, EL-Haakah, EL-Mearixh, Abese, Tekviir, El-Infitar, El-Inshikak, Buruxh, Murselat, Nebe', En-Naziat, Fexhr, Beled, Shems, EL-Lejl, Duha, Tarik, Ea'la, Gashijeh, Karia', Tekathur, Asr, Humezeh, Inshirah,

Et-Tin, Alek, Adijat, Kafirun, Mesed, Fiil, Kurejsh, Mauun, Kevther.

- **Sure Medinase. Janë 20 sure.**

**Dhe ato janë siç vijojnë:** El-Bekareh, Ali-Imran, Nisa', Maideh, Enfal, Tevbeh, Nuur, El-Ahzab, El-Xhumuah, Muhammed, Fet'h, Huxhurat, Hadid, Muxhadeleh, Hashr, Mumtehineh, Munafikun, Talak, Tahrin, dhe En-Nasr.

- **Sure ku ka divergjenca mes dijetarëve (Se a janë mekkase apo medinase). Janë 12 sure.**

**Dhe ato janë siç vijojnë:** El-Fatiha, Er-Ra'd, Rahman, Saaf, Tegabun, Mutafifin, Kadr, Bejjineh, Zilzileh, El-Ihlas, Felek, dhe En-Nas.

#### **6- Njohja se kjo është Sure Mekkase apo Medinase.**

- **Metodologjia nëpërmes ndëgjimit.** Zinxhiri shkon deri te transmetuesi i saktë nga sahabët dhe të tabiinëve, të cilët kanë qenë present me të ndëgjuarit e tyre duke i ndëgjuar ajetet se ku kanë zbritur dhe për kë ka zbritur, apo tabiinët kanë qenë që kanë ndëgjuar prej sahabëve duke ditur zbritjen e ajetit apo vendin dhe kohën kur është zbritur.
- **Metodologjia duke u përpjekur me analogji.** Transmetimet e veçanta mekkase dhe ato medinase, dhe kjo shpjegohet, se nëse me një sure mekkise ka ajet ku tregohet shkakun se pse është zbritur, atëherë kjo konsiderohet si sure medinise përshkak të asaj ngjarje apo sebepe pse ka zbritur, ose nëse vërtetohet ndonjë ngjarje apo ndonjë tregimi i pejgamberëve apo popujve të mëparshëm, dhe mu për

këtë shkak gjejm si p.sh duke thënë çdo sure ku përmenden tregime ato janë mekkije, ndërsa nëse në çdo sure ku përmenden obligimet apo ekzekutimet ato janë medenije.

### 7- Definimi se kjo është Mekkije apo Medenije. Këtu kemi tre mendime.

- **Njohja se për cilën kohë flet.** Kjo njihet nëpërmes një thënie të njohur, dhe me këtë definim është ndarë i gjithë Kur’ani, dhe nuk del asgjë nëse ka qenë hixhreti në mekke e të jetë medinase (çfarë ka zbritur pas hixhrit), mirëpo ky definim përfshin çdo send çfarë ka zbritur në vitin e çlirimit, apo në vitin e haxhit të lamtumirës; si p.sh. Ajeti (**El-Jevme Ekmeltu Lekum Dinnekum Ve etmemtu Alekjum Nimetu Le-Reditu Lekumul-Islame Dina**) d.m.th. “Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe” [**El-Maide. 3**]

Ky ajet përfshinë çfarë ka zbritur pas hixhrit jashta medines në një udhtim prej udhtimeve kur kanë marr rrugën naj betej prej betejave.

-Dhe definimi është se Mekkase quhet çdo ajet, që ka zbritur para hixhretit edhe nëse kanë qenë në medine, dhe Medinase quhet, çdo ajet që ka zbritur pas hixhertit edhe nëse kanë qenë në mekke.

Si p.sh ajeti i cili ka zbritur në vitin e çlirimit, ku Allahu te’ala ka thënë: “All-llahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni...” [**En-Nisa. 58**] apo ajetin i cili ka zbritur në haxhin e lamtumirës ku Allahu te’ala ka thënë: ‘ Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe’ [**El-Maide. 3**]

- **Njohja se kujt i është drejtuar.** Kjo definohet se Mekkase është çdo send që Allahu ju është drejtuar (duke ju folur, qoftë obligative apo ndalesë), banorëve të

mekkes, ndërsa Medinase është çdo send që i është drejtuar banorëve të medinës. Sepse shumica e njërzve në mekke kanë qenë banorë të kufrit, si p.sh me ajetet ku ka folur Allahu: **‘Ja Ejuhen–Nassu’** d.m.th. ‘O ju njerëz’. Ndërsa në Medine Allahu iu është drejtuar me: **‘Ja Ejuheli–Ledhine Amenu’** d.m.th. ‘O ju të cilët keni besu’, në këtë formë përshkak se shumica e popullit në medine kanë qenë besimtarë (Musliman).

Dhe ky rregull nuk do të thotë që është çdo herë ashtu sepse ka mundësi Allahu ju ka folur apo drejtuar me dy thirrjet si ajo ‘O ju njerëz’. Kështu përmendet në **[Suren El–Bekare]** dhe **[Suren En–Nisa’]**, dy suret janë Medinase edhe pse Allahu ju ka folur banorëve të Mekkes.

- **Njohja për vendodhjen se ku ka zbritur:** Mekkase quhet çdo ajet apo sure që ka zbritur në mekke, dhe Medinase quhet çdo ajet apo sure që ka zbritur në Medine, dhe kjo renditet në bazë të mendimit dhe veçimit të ndonjë pjese. Dhe ka mendim të dijetarëve duke thënë që ajete Mekkase quhet çdo ajet që ka zbritur pas hixhretit.

## 8– Veçorit dhe rregullat se, pse Mekkase.

### Prej Rregullave:

- a) Çdo sure në të ka Sexhde
- b) Çdo sure në të ka Fjalën **‘Kel–la’** (Assesi)
- c) Çdo sure në të (kur ju drejtohet Allahu fillon) me **‘Ja Ejuhen–Nass’** (O ju njerëz)
- d) Çdo sure në të ka tregimet e Pejgamberëve dhe popujve të mëhershëm.



e) Çdo sure në të ka tregimin e Ademit a.s dhe Iblisit.

f) Çdo sure në të fillon me shkronjat e shkurtra duke filluar me shkronjat si p.sh: Elif-Lam-Mim, Elif-Lam-Ra, Haa Miim, etj.

### Prej veçorive:

- Thirrja për në Teuhid dhe adhurim ndaj Allahut te'ala, dhe përmendet Kijameti, Xhenneti dhe Xhehennemi, dhe dialogu me politeistët.
- Përqeshen punët e politeistëve për derdhjen e gjakut me të padrejt, dhe për ngërien e pasurisë së jetimit, dhe mbytjen e vajzave.
- Fuqin e fjalëve të shkurtra mirëpo me kuptim të madhë, dhe metaforën.
- Tregon vuajtjet e pejgamberëve dhe përgënjeshttrimet e popujve të tyre.

### 9- Veçorit dhe rregullat se, pse Medinase:

#### -Prej Rregullave:

- Qartësimi i adhurimeve dhe jurisprudencës islame, gjykimet, xhihadi, luftrat, rregullat e familjes, rregullat e gjykatës, dhe mjetet si arrihet sheriati.
- Qëndrimet me popujt e librave si (Jehudët dhe të krishterët), dhe thirrja e tyre në islam.
- Zbulimi i cilësive të munafikëve (hipokritëve), dhe rreziku prej tyre.
- Rregullat e moralit (Etikës islame), dhe të manifestuarit e këtyre në jetën e përditshme.

## 10-Suret Mekkase dhe Medinase në bazë të zbritjes së tyre.

**Suretu**–Fexhr, Alak, Nun, Muzzemil, Mudethir, El-Fatiha, Mesed, Et-Tekvir, El-A’la, Lejl, El-Kafirun, Ed-Duha, Esh-Sherh, Asr, El-Adijat, Kevther, Tekathur, El-Mauun, El-Buruuxh, Ef-Fiil, Felek, Naas, Ihlas, Nexhm, Abes, Kadr, Shems, Tarik, Tiin, Kurejsh, Karia’h, Kijameh, Humezeh, Murselat, Kaf, Beled, Kamer, Saad, El-A’raf, Xhinn, Jasin, Furkan, Fatir, Merjem, Taha, El-Vakiah, Shuudara’, Tassim, Neml, Kasas, Isra’, Junus, Hud, Jusuf, Hixhr, Saafaat, Lukman, Sebe’, Zumer, Gafir, Sexhdeh, Fussilet, El-Ena’m, Zuhruf, Duhan, Xhathijeh, El-Ahkaf, Dharijat, Gashijeh, Asek, Shuura, Ibrahim, El-Enbija’, El-Mearixh, El-Mu’minun, Kehf, Nahl, Nuh, Nebe’, En-Naziat, Infirat, Inshikak, Tuur, Mulk, El-Haakah, Mutaffifin, El-Bekareh, El-Enfal, Ali-Imran, Ahzab, Ruum, Ankebut, Zilzileh, El-Hadid, Muhammed, Read, Rahman, Insan, Mumtehineh, En-Nisa’, Hashr, Nuur, El-Haxh, El-Munafikun, El-Muxhadeleh, Huxhurat, El-Bejjineh, Talak, Es-Safa, El-Xhumuah, Fef’h, El-Maideh, Beraetun, Nasr, Tahrim, Tegabun.

## 11- Rëndësia e diturisë, se pse Mekase dhe Medinase.

- Rëndësia e kësaj është se, ajetet mekkase dhe medinase prej tyre ka ajete të derogume dhe jo të derogume, dhe do vije në kapitullin tjetër kur do flasim për këtë çështje të rëndësishme, shkak i asaj se kjo na ka ndihmuar, dhe njëherit kjo është mirsi sepse na ka mundësuar të kuptuarit e renditjes së sureve.
- Dituria mbi ajetet Mekase dhe Medinase, e nxit studijuesin në njohjen e historisë se si nxirren aktgjykimet, gjithashtu mëson se çfarë rëndësie ka sunneti i Allahut në nxjerrjen e vendimeve, duke mësuar edhe çfarë është bazë (esencë) dhe çfarë është degë, të mëson se si të mendosh për vetën tënde, pastaj të mëson edhe gjykimet, urdhëresat dhe ndalesat, dhe kjo njëherit ta lehtëson rrugën se si ti

thërrasësh njerëzit dhe si ti nxjerrësh konkluzionet.

- Duhesh të mbështetësh dhe të kërkosh ndihmë prej Allahut që ta mësosh këtë dituri dhe njëkohsisht edhe ta kuptosh.
- Kjo mënyrë të nxit qëta shijosh metodën e Kur'anit, dhe të përfitosh metoda se si të bësh davet.
- Të ndalurit rreth historisë së të dërguarit tonë Muhamedit alejhi selam, prej ajeteve të Kur'anit.

## 12- Shembuj prej ajeteve Mekkase në suret Medinase dhe e kundërta.

- **Ajete Mekkase në suret Medinase.**
- Suretul-Enfal e gjitha është Medinase deri te, ku Allahu te'ala thotë:” O Pejgamber! All-llahu të mjafton ty dhe besimtarëve që janë me ty.” [El-Enfal, 64]
- Suretul-Muxhadele e gjitha është Medinase deri te, ku Allahu te'ala thotë:” A nuk e di ti (o dëgjues) se All-llahu di çka ka në qiej dhe çka ka në tokë?! Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i katërti...” [El-Muxhadele, 7]
- **Ajete Medinase në sure Mekase.**
- Suretul-Junus e gjitha është Mekase deri te, ku Allahu te'ala thotë:” Ka prej tyre (te të cilët u dërgua Muhammedi) që e besojnë atë (Kur'anin), e ka prej tyre edhe asish që atë nuk e besojnë.” [Junus, 40].
- Gjithashtu në të njëjtën sure kemi edhe ajetin, ku Allahu te'ala thotë:” Po, (fjala vjen), nëse je në dyshim për këtë që të zbritëm ty (për ngjarjet e pejgamberëve), atëherë pyeti ata që lexojnë librin para teje. Ty të erdhi nga Zoti yt e vërteta, pra,

mos u bë prej atyre që dyshojnë. Dhe mos u bë prej atyre që i përgënjeshtroan argumentet e All-llahut, e të bëhesh nga të dështuarit. [Junus. 94-95]

- Suretul-Kehf e gjitha është Mekase deri te, ku Allahu te'ala thotë:” Falënderimi i takon vetëm All-llahut që ia shpalli robit të vet Librin dhe në të nuk lejoi ndonjë kundërthënie. (ia shpalli) Të saktë (pa shmangie), pët t’ua tërhequr vërejtjen (atyre që nuk besojnë) ndaj një dënimi të rëndë prej Tij, e për t’i përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm. Duke qenë në të përgjithmonë. Për t’ua tërhequr vërejtjen atyre që thanë se All-llahu ka fëmijë. Dhe për atë (fëmijë), as ata, e as të parët e tyre nuk kanë kurrfarë dijenie. Sa e madhe është ajo fjalë që del nga gojët e tyre, e ata nuk thonë tjetër vetëm se gënjeshtër. A thua ti do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kur’anit)? Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t’i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë. Ne kemi për ta bërë gjithçka që është mbi të dhë pa bimë (shkatërrojmë çdo gjelbërim). [El-Kehf. 1-8]

### 13- Kush i ka memorizuar (pëmendësh) prej Mekes në Medine dhe e kundërta.

- **Kush i ka memorizuar prej Mekes në Medine.**
- Suretu-E’ala, ka memorizuar: 1-Musab Ibn Umejr, 2-Ibn Umm Mektuum radijallahu anhuma.
- Suretu-Jusuf, ka memorizuar: 1-Avf Bin Ufra’, i cili në të tetëdhjetat ka qenë prej atyre që i ka shërbyer Pejgamberit më të dashur Muhamedit alejhi selam, në mekke.
- Pastaj ka memorizuar Suretul-Ihlas.

- Pastaj ka memorizuar edhe prej Sures-El-A'raf ku Allahu te'ala thotë: “Thuaj (Muhammed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i All-llahut te të gjithë ju.”

[El-A'raf, 158]

- **Çfarë kanë memorizuar (Përmendësh) prej Medines në Mekke.**

- Kanë memorizuar ajetin e Ribas (kamatës), prej medines në mekke, dhe ka lexuar Utab ibn Usejd atyre: “O ju që besuat, kini frikë All-llahun dhe nëse jeni besimtarë të singert , hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata.” [El-Bekare, 278]

- Suretul-Bera' ka memorizuar Ebu Bekr Es-Siddiku r.a në vitin e nëntë, ka qenë Emir në Haxh, dhe ka lexuar Ali Ibn Ebi Talib r.a lexoi një dit prej ditve ajetin:”Përveç atyre që ishin të paaftë nga burrat, grat e fëmijët që nuk kishin mundësi të gjenin, as mënyrë, as rrugë (për shpërngulje). Atyre do t’iu falë All-llahu. All-llahu është që shlyen e falë shumë (gabime). [Suretu-En-Nisa, 98, 99]

- **Çfarë kanë memorizuar (Përmendësh) prej Medines në Habeshe.**

- Kanë memorizuar prej Medines në Habeshe Suretul-Mejrem, dhe kjo vërtetohet nga Xhe'fer ibn Ebi Talib kur i ka lexuar prej kësaj sure Nexhashiut.
- I Dërguari i Allahut Muhamedi alejhi selam e dërgoi apo porositi Xhea'fer ibn Ebi Talib me këto ajete për në Habeshe, ku Allahu te'ala thotë:” Thuaju (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush. Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut”! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi

muslimanë (besuam një Zot)!”! [Ali-Imran. 64]

Dhe ajetin 68 të sures Ali Imran ku Allahu thotë:” Njerëzit më me meritë për t’u thirrur në Ibrahimin, ishin ata që e ndoqën atë (besimin e tij) dhe ky Pejgamber me ata që besuan (ummeti i këtij). All-llahu është mbrojtës i besimtarëve.”

[Ali-Imran. 68]

- Çfarë ka zbritur në stinën e verës dhe dimërit.

-Prej ajeteve që kanë zbritur në verë janë:

a) Është ajeti në Suretu En-Nisa’, ku flet Allahu për trashëgimin siç thotë:”

Kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: “All-llahu ju përgjigjet në çështjen e “**Kelale-s**” (ai që nuk ka prindër as fëmijë që e trashëgojnë). Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj (motrës) i takon gjysma e pasurisë së lënë. Ai (vëllau) trashëgon tërë atë (që le motra) nëse ajo nuk ka fëmijë. Në qoftë se ato janë dy (motra që trashëgojnë), atyre dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai. Në qoftë se janë vëllezër dhe të përzier burra dhe gra, atëherë mashkullit i takon hise dy fish më shumë se sa femrës. All-llahu ju sqaron, ashtu që të mos humbni. All-llahu di për çdo send.” [En-Nisa’, 176]

- Në këtë stinë ka zbritur edhe ajeti ku Allahu te’ala thotë:”Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe.”

[Suretu1-Maideh. 3]

- Edhe ajetin ku Allahu te’ala thotë:”Dhe ruajuni një ditë kur në të ktheheni te All-llahu, dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë.” [Suretu1-Bekare. 281]

- Gjithashtu dhe ajetin ku Allahu te’ala thotë:” E nëse i pyet ti ata (përse tallen),

do të thonë: “Ne vetëm jemi mahnitur e dëfruar”. Thuaj: “A me All-llahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?”. [Et-Tevbeh. 65]

- Dhe ajetin po në të njëjtën sure ku Allahu te’ala thotë:” Ata (hipokritë) që mbetën (pa shkuar në luftë), u gëzuan për ndejen e tyre pas të dërguarit të All-llahut dhe nuk dëshiruan që të luftonin me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e All-llahut dhe thanë: “Mos dilni (në luftë) në vapë!” Thuaju: “Zjarri i xhehennemit ka vapën edhe më të fortë, nëse janë që kuptojnë!”. [Et-Tevbeh. 81]

- Prej ajeteve që kanë zbritur në dimër janë.

- Kemi ajetet që flasin për betejën e Hendekut prej suretul-El-Ahzab ku Allahu te’ala thotë:” O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e All-llahut ndaj jush, kur juve u erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e All-llahu e shihte atë që ju vepronit.” [El-Ahzab. 9]

- Ajetin për shpifjen që iu është bërë nënës së besimatarëve Aishes r.a, dhe tregohet që ka zbritur në dimër. Allahu te’ala thotë:” S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që e barti pjesën e madhe (të shpifjes), i takon dënimi i madh.” [En-Nur. 11]

• Çfarë ka zbritur në vende të veçanta apo specifike.

• Prej ajeteve që kanë zbritur në **Taif**, kemi ajetin ku Allahu te'ala thotë: "A nuk e sheh se si Zoti yt e zgjati (andej e këndej) hijen, e sikur të kishte dashur do ta linte në një vend, pastaj diellin e bëmë rrëfyes të saj." [El-Furkan, 45]

• Çfarë ka zbritur në **Bejtul-Makdis**, Allahu te'ala thotë: "E ti pra, pyeti ata të dërguarit që i dërguam para teje, a kemi lejuar që në vend të All-llahut të adhurohen zota të tjerë?" [Ez-Zuhruf, 45]

• Çfarë ka zbritur në **Hudejbije**, Allahu te'ala thotë: "Kështu, Ne të dërguam te një popull, para të cilit kaluan shumë popuj, e që t'ju komunikosh atë që Ne ta shpallëm ty, sepse ata janë duke e mohuar Mëshiruesin (Zotin). Thuaj: "Ai (Rrahmani) është Zoti im, nuk ka zot tjetër pos Atij. Vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm te Ai është e ardhmja ime". [Er-Ra'd, 30]

• Çfarë ka zbritur në **Xhuhfeh**, Allahu te'ala thotë: "S'ka dyshim se Ai që ta bëri obligim Kur'anin, Ai do të kthejë ty aty kah erdhe. Thuaj: "Zoti im e di më mirë kush është që solli udhëzim të drejtë dhe kush është në humbje të sigurt". [El-Kasas, 85]

-Njohja e ajeteve se cili ajet ka zbritur i pari dhe cili i fundit.

• Ajeti i parë i cili ka zbritur në Kur'ani Kerim është ajeti ku Allahu te'ala thotë: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)." [El-Alek, 1]

• Ndërsa ajeti i fundit i cili ka zbritur në Kur'ani Kerim është: "Dhe ruajuni një ditë kur në të ktheheni te All-llahu, dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë." [El-Bekare, 281]



-Prej sureve dhe ajeteve të parat dhe të fundit që njihen me çështje të veçuara.

- Të parat që kanë ardhur me çështje të veçanta.
- Sureja që ka zbritur komplet El-Fatiha.
- E para e cila ka zbritur në legjitimin e Xhihadit, kemi ajetin ku Allahu te'ala thotë: "Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejt, e All-llahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (muslimanëve)." [El-Haxh. 39]
- E para e cila ka ardhur në ndalesën e Alakoholit, në ajetin ku Allahu te'ala thotë: "Të pyesin ty për verën (Alkohol) dhe bixhozin. Thuaj: "Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre. Të pyesin ty edhe se ç'do të japin. Thuaj: "Tepricën"! Kështu ua sqaron All-llahu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq)." [El-Bekare. 219]
- E para e cila ka ardhur në Ushqimet, kemi ajetin ku Allahu te'ala thotë: "Thuaj: "Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai është i ndytë, dhe pos asaj që është therrur jo në emër të All-llahut (por të ndonjë idhulli) e që është mëkat. E kush detyrohet (t'i hajë këto të ndaluara), por duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, Zoti yt është që falë e mëshiron shumë." [El-En'am. 145]

- Të fundit që kanë ardhur me çështje të veçant.

- E të fundit që ka ardhur është përmendja e grave nveçanti, kemi ajetin ku Allahu te'ala thotë: "Zoti i tyre iu përgjegj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri por ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i vejë në xhennete në të cilët burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e All-llahut, se më i miri i shpërblimeve është tek All-llahu." [Ali-Imran. 195]

- Të fundit që ka ardhur në trashigimi, kemi ajetin ku Allahu te'ala thotë: "Kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: "All-llahu ju përgjigjet në çështjen e "**Kelale-s**" (ai që nuk ka prindër as fëmijë që e trashëgojnë). Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj (motrës) i takon gjysma e pasurisë së lënë. Ai (vëllau) trashëgon tërë atë (që le motra) nëse ajo nuk ka fëmijë. Në qoftë se ato janë dy (motra që trashëgojnë), atyre dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai. Në qoftë se janë vëllezër dhe të përzier burra dhe gra, atëherë mashkullit i takon hise dyfish më shumë se sa femrës. All-llahu ju sqaron, ashtu që të mos humbni. All-llahu di për çdo send." [En-Nisa. 176]

- Dhe sure e fundit ka zbritur **Sureja En-Nasr**.

**E Lus Allahun Subhanehu ue te'ala që të e pranoj këtë vepër nga unë, dhe ta bëjë argument ndaj meje ditën e gjykimit e jo kundër meje, dhe të më fal mua dhe prindërit e mi, dhe ata që më mësuam mua, dhe ata të cilët kanë hak ndaj meje, e thënia e fundit është falënderimi i takon Allahut subhanehu ue te'ala.**

## Fund

Përktheu dhe përshtati:

**Faik ASANI**

Për webfaqën: [www.thirrjaislame.com](http://www.thirrjaislame.com)

Me date: 05/09/2012